

**Shoqëria "Erseka Solar Park 3" sh.p.k**

**Adresa:Korce,Shqiperi**

**Cel: +355 69 404 4556**

**Email : info@mkenergy.al**

**Korce me, 14 /10 /2023**

**STATUT**  
**I**  
**SHOQERISE TREGTARE**  
**"ERSEKA SOLAR PARK 3" SH.P.K**

Shoqëria "M&K ENERGY TRADING CO" sh.p.k, person juridik me NIPT: M04516001I me seli në Korçë: Kompleksi Favina, Godina Nr.5, Lagjia 18 Rruga "Anastas Lakçe", me objekt veprimtarie Prodhim i energjisë elektrike nga hidrocentralet, parqet fotovoltaike, parqet eolike, blerje dhe shitje me shumicë dhe pakicë e energjisë elektrike nga njësitë e prodhimit të subjekteve të licensuar tek konsumatorët, etj përfaqësuar nga Administratori Viktor Qylafi, datëlindja 03.02.1963 posedues i letërnjoftimit me nr.personal: G30203019R .

Me nenshkrimin e ketij Statuti, themeluesi gezon te drejtat dhe merr persiper te respektoje detyrimet e meposhtme.

**KREU I**  
**EMRI, ORTAKET, SELIA, KOHEZGJATJA**

**NENI 1**  
**Emri i shoqerise**

1.1 Emri i shoqerise eshte "ERSEKA SOLAR PARK 3" sh.p.k

1.2 Emri i shoqerise tregtare, kapitali themeltar si dhe emri i ortakut duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxjerr kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te treteve.

1.3 Shoqeria e emertuar "ERSEKA SOLAR PARK 3" sh.p.k (me poshte e quajtur shoqeria) eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e krijuar ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise.

Shoqeria eshte themeluar ne baze te Ligjit Nr.9901 date, 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar dhe fiton personalitet juridik pas rregjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar Shqiptar te mbajtur prane Qendres Kombetare te Biznesit (QKB).

**NENI 2**



## Ortakët

2.1 Ortak I vetem I shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "ERSEKA SOLAR PARK 3" sh.p.k do të jetë Shoqëria "M&K ENERGY TRADING CO" sh.p.k, person juridik me NIPT: M04516001I me seli në Korçë: Kompleksi Favina, Godina Nr.5, Lagjia 18 Rruga "Anastas Lakçe", me objekt veprimtarie: "Prodhim i energjisë elektrike nga hidrocentralet, parqet fotovoltaike, parqet eolike, blerje dhe shitje me shumicë dhe pakicë e energjisë elektrike nga njësitë e prodhimit të subjekteve të licensuar tek konsumatorët, etj" me Administrator Viktor Qylafi, datëlindja 03.02.1963 posedues i letërnjoftimit me nr.personal: G30203019R, zoteruese e 100% të vlerës së kapitalit të shoqërisë.

## NENI 3

### Selia

3.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën:Rruga:"DHORA LEKA" Korçë, Shqiperi me Nr.pasurie 3/1149-N5/2 , vol. 58 , fq. 001, ZK. 8561.

3.2 Shoqëria mund të hap zyra përfaqësimi, degë dhe/ose filiale të marrë pjesë në shoqëri të tjera, të kryejë aktivitete në vende të tjera, qoftë brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve .

## NENI 4

### Kohëzgjatja e Veprimtarisë

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë e pakufizuar.  
Asambleja e Ortakëve të shoqërisë mund ta kufizojë ose ta zgjasë afatin e veprimtarisë së Shoqërisë.

## NENI 5

### Vula e shoqërisë

Shoqëria do të ketë vulën e saj duke shënuar në të emrin e shoqërisë ose iniciale ESP  
3

## KREU II

### OBJEKTI,KAPITALI,TRANSFERIMI I KUOTAVE

## NENI 6

### Objekti

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj ushtrimin e aktiviteteve si më poshtë :

a) Prodhim i energjisë elektrike nga parqet fotovoltaike, eolike dhe hidrocentralet;



- b) Blerja dhe shitja me shumicë dhe pakicë e energjise elektrike nga njësitë e prodhimit të subjekteve të licensuar tek konsumatorët;
- c) Shitja e energjise elektrike kilenteve dhe blerja e energjise elektrike nga operatorë të ndryshem privat apo shtetëror brenda dhe jashtë vendit;
- d) Konsulencë për tregtimin e energjise elektrike, për disbalancat energjisë elektrike;
- e) Përfaqësim tregtar dhe agjensi;
- f) Blerje trojesh prona të tjera.
- g) Për aktivitetin e saj Shoqëria mund të kryejë veprime me pasuri të luajshme dhe të paluajshme, si dhe të administrojë, blejë, shesë, ose të marrë me qira, të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri të tjera, konsorciume të themeluara ose në themelimin e siper, që kanë objekt të ngjashëm të veprimtarisë me objektin e Shoqërisë ose objekti i tyre i shërben qëllimit të realizimit të objektit të Shoqërisë, të angazhohet në hapjen e stacioneve të plazhit, hoteleri, turizem dhe aktivitetet e rekreacionit.
- h) Cdo veprimtari tjetër që nuk ndalohet me ligj.

## NENI 7

### Kapitali

7.1 Kapitali themeltar/i regjistruar i Shoqërisë është 100,000 (njqind mijë) lek.

7.2 Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij si më poshtë:

Ortaku i vetëm themelues "M&K Energy Trading Co" sh.p.k zoteron 100%(njqind përqind) të vlerës së kapitalit themeltar, të shoqërisë, që përfaqëson gjithë kapitalin e shoqërisë me vlerë 100,000 (njqind mijë) lek.

7.3 Kapitali është nënshkruar dhe shlyer teresisht nga ortaku i vetëm i shoqërisë.

7.4 Përgjegjësia e ortakut të vetëm shtrihet deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e shoqërisë.

7.5 Kapitali i shoqërisë mund të rritet në të ardhmen:

- a) Me vendim të Asamblesë së Ortakëve ku do të miratohet si rritja e kapitalit themeltar ashtu dhe hyrja e ortakëve të rinj.
- b) Nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së kuotave të reja nga ortakët e rinj.

7.6 Zvogelimi i kapitalit të shoqërisë do të realizohet duke u bazuar në dispozitat e vecanta që parashikohen nga Ligji nr.9901. Datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të ndryshuar.

7.7 Kapitali i shoqerise do te perbehet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros, detyrimet e ortakut te vetem, hua, pasuri te lujatshme apo te paluajtshme si dhe instrumenta te tjera per ndryshimin e aktivitetit te shoqerise.

## **NENI 8**

### **Menyrat e fitimit dhe kalimit te kuotave**

1. Kuotat e kapitali te shoqerise e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet :

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashegimise;
- d) Dhurimit;
- e) Cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj

2. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

## **KREU III**

### **ORGANET DREJTUESE**

#### **NENI 9**

Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe ushtron aktivitetin e saj pas regjistrimit si subjekt tatim pagues.

Organet kryesore te Shoqerise jane:

-Asambleja e ortakeve

-Administratori

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit te organeve drejtuese rregullohet si me poshte.

#### **NENI 10**

### **Asambleja e Ortakeve**

#### **10.1 Funksioni dhe Kompetencat;**

10.1.1 Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve e thirrur rregullisht, perfaqeson te gjithë Ortaket e shoqerise dhe eshte organi me i





larte vendimarres i shoqerise.

Ne perputhje me legjislacionin shqiptar ,Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te marre vendimet e meposhtme,por pa u kufizuar vetem ne to:

- a) Percaktimin e politikave te biznesit;
- b) Emerimin dhe shkarkimin e admiistratorit (eve);
- c) Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel;
- d) Rritjen dhe zvogelimin e kapitalit te Shoqerise;
- e) Zbatimin dhe miratimin e pasqyrave financiare per llogarite vjetore,te aadministrimit dhe te raporteve te mbikeqyrjes;
- f) Miratimin e rregullave procedurale ne lidhje me Mbledhjen e Asamblese se Ortakeve.
- g) Miratimin e shperndarjes se fitimit vjetor;
- h) Miratimin e skemes se kompesimit per Administratorin, Likuiduesin dhe ekspertet kontabel;
- i) Ristrukturim, prishjen, transformimin, bashkimin, likujdimin e shoqerise riorganizimin e Shoqerise ne ndonje forme tjeter Shoqerie;
- j) Marrjen e te gjitha masave me qellim qe te sigurohet qe Shoqeria te kete kapital dhe asete te mjaftueshme per ushrimin e aktivitetit dhe permbushjen e detyrimeve kundrejt te treteve;
- k) Te hipotekojne ,lemne peng dhe vendosin cdo barre mbi asetet e veta dhe te lidhin cfaredo marreveshje financiare me cdo pale financuese, me kusht qe hioteka, pengu apo barret e tjera, po ashtu si dhe marreveshjet perkatese financiare, te sherbejne per mbushjen e detyrimeve te percaktuara ne nenin 4;
- l) Krijimin,mbylljen dhe/ose prishjen e degeve,zyrave te perfaqesimit dhe filialeve;
- m) Cdo ceshtje tjeter qe percaktohet nga ligji dhe nga ky statut.

## **10.2 Thirrja e Asamblese**

10.2.1 Administratori sipas gjykimit te tij te kire ose me kerkesen e nje dhe/ose me shume Ortakeve te cilet perfaqesojne te pakten 5% te kapitalit te Shoqerise, dhe/ose eksperti kontabel i autorizuar, nese ka, dhe/ose likujduesit kane te drejte te therrasin Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve.

Ortakeve duhet t'u dergohet nje njoftim me shkrim per mbledhje me ane te postes se regjistruar apo me e-mail, jo me pak se 7(shtate) dite perpara dates se mbledhjes,qe permban te dhenat per arsyen e mbledhjes,vendin, daten dhe oren e saj.

10.2.2 Verifikimi i njoftimit te mbledhjes nuk eshte i nevojshem ne te gjithe Ortaket jane te pranishem apo jane te perfaqesuar,ne perputhje me nenin 10.2.1.

## **10.3 Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme**

10.3.1 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligji,statuti dhe

sa here eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise.

10.3.2 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet nese:

- a) Rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 (tre) muajve sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare;
- b) Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5% te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

10.3.3 Asambleja e pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

10.3.4 Asambleja e pergjithshme mund te zhvillohet ne seline e shoqerise, ose online pas realizimit te komunikimit ne adresen elektronike te dhene nga ortaket.

#### **10.4 Kuorumi**

10.4.1 Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

10.4.2 Ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te cilesuar, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike.

#### **10.5 Marrja e vendimeve**

10.5.1 Asambleja e Pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te ortakeve pjesemarrës në rastet kur kërkohet :


- a) ndryshimi i statutit,
- b) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar,
- c) shpërndarja e fitimeve riorganizimi,
- d) prishja e shoqërisë.

10.5.2 Me perjashtim te rasteve te parashikuara sa me siper ne piken 10.5.1, per te gjitha pikat e tjera te percaktuara ne piken 10.1.1, Asambleja e Pergjithshme do te vendose me shumicen e votave te ortakeve pjesemarrës.

### **NENI 11**

#### **ADMINISTRATORI**

11.1 Administrimi i shoqerise do te kryhet nga nje Administrator i vetem qe





eshte, Kristi Qylafi, i biri i Viktor Qylafi, i datelindjes 06.09.1997, lindur ne Korce dhe banues ne Korce, mbajtes i leternjofimit 032569947 dhe nr personal: J70906030C.

11.2 Administratori i vetem do te qendroje ne kete detyre per nje periudhe 5 (pese) vjecare nga dita e depozitimit te Statutit ne QKB.

## NENI 12

### KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

12.1 Administratori i Shoqerise ka te drejte e detyrohet te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare re Shoqerise. Ai ushtron te gjitha kompetencat sipas percaktimeve te nenit 95 te Ligjit nr.9901, date 14.04.2088 "*Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare*", të ndryshuar.

12.2 Administratori i vetem ka te gjitha te drejtat e fuqite per drejtimin e zakonshem te Shoqerise, me qellim arritjen e objektivave te saj.

12.3 Administratori i Shoqerise ka te drejte te emeroje perfaqesues te posacem dhe te delegoje kompetencat e tij.

12.4 Administratorit te vetem i takon firma e lire dhe perfaqesimi i Shoqerise ndaj te treteve ne veprime, procedura dhe seanca gjyqesore, si dhe pajtime dhe kompromise, pasi te kete marre vendimin e Asamblese.

12.5 Administratori eshte pergjegjes, sipas rastit ndaj shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit apo deme te kryera gjate ushtrimit te detyres.

12.6 Kompetencat kryesore te Administratorit te shoqerise jane:

- a. Te hartoje planet e llogarive ekonomike.
- b. Te hartoje akte normative qe percaktojne raportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin dhe personelin.
- c. Te perfaqesoje Shoqerine me te tretet ne te gjitha veprimtarine e saj.
- d. Te percaktoje strukturat e aparatit te shoqerise dhe te krijojte organe te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te Shoqerise.
- e. Te perzgjedhe ekspertet kontabel dhe anetaret e komisionit te likujdimit.
- f. Te percaktoje numrin e punonjesve te shoqerise dhe pagat e tyre.
- g. Te vendose rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve te ndryshme (te vecanta), etj;
- h. Te perfaqesoje shoqerine ne regjistrin e prones sipas ketij statuti.
- i. Te mbikqyre dhe te zbatoje veprimtarite dhe politikat tregtare te Shoqerise dhe vendimet e Asambles se Ortakeve ;
- j. Me kerkese te Asamblese se Ortakeve , te nderrmarrë masa te cilat jane kompetencë e kesaj te fundit, te propozoje vendimet qe do te miratohen

- nga Asambleja e Ortakeve dhe t'i zbatoje keto vendime ;
- k. Të sigurojë që Shoqëria respekton ligjin e zbatueshem dhe standartet kontabel;
  - a. Të kryejë te gjitha veprimet ne lidhje me administrimin e aktivitetit tregtar te Shoqerise;
  - b. Të sigurojë dokumentet dhe librat kontabel te Shoqerise te mbahen ne rregull dhe me saktesi;
  - c. Të thërrasë një mbledhje te Asambles se Pergjitheshme kur e vlersojne te nevojeshme per mbrojtjen e interesave te Shoqerise;  
Të pergatite dhe nenshkruaje pasqyrat financiare vjetor te Shoqerise, pasqyrat financiare te konsoliduara, te cilat bashke me propozimin per shperndarjen e fitimit i paraqiten per miratim Asamblese se Ortakeve;
  - ç) Të kryej te gjitha regjistrimet dhe publikimet e deyrueshme ne lidhje me shoqerine , sipas parashikimeve te ligjit te zbatushem;
  - d) Të miratoje hapjen e cdo procedure ligjore ose mbylljen e tyre;

## **KREU IV** **KUSHTET EKONOMIKE**

### **NENI 13**

Shoqeria eshte pronare,perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj.  
Ajo vepron ne Regjistrin e Pasurive te Paluajtshme si cdo person tjetër juridik ne Shqiperi mund te bleje, shese, te jape ne perdorim, te ngarkoje me barre per detyrime ndaj te treteve ose per kredi bankare, etj,

### **NENI 14**

Shoqeria ka llogarine e saj rrjedhese, si dhe librin e saj te llogarive ne baze te kerkesave te ligjitper kontabilitetin e dispozitave te tjera fiskale.  
Transferimi i mjeteve monetare hde transaksionet financiare do te kryhen ne baze te kritereve te caktuara nga Banka e Shqiperise.

### **NENI 15**

Veprimet ekonomiko-financiare te shoqerise nisin; vitin e pare ne momentin e regjistrimit ne QKR dhe ne organet tatimore e mbyllen ne 31 dhjetor te cdo viti. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore hartohet bilanci kontabel sipas ligjeve ne fuqi.  
Bilancet periodike (mujore, tremujore, gjashtemujore) miratohen e nenshkruhen nga administratori i shoqerise. Bilancet vjetore miratohen nga asambleja e ortakeve e nenshkruhen nga administratori dhe depozitohen ne QKR e ne Tatim Taksa.Llogarite vjetore, inventaret, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e vecanta te hartuara nga Administratori dhe eventualisht eksperti kontabel i autorizuar, miratohet nga ortaaket.  
Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda 3 muajve nga mbyllja





e vitit financiar.

Kontrolli i shoqerise kryhet nga eksperti Kontabel i Autorizuar, i emeruar per tre vite financiare me mundesi rizgjedhje, nga ortaket.

Shkarkimi i Ekspertit Kontabel te Autorizuar, i emeruar per tre vite financiare me mundesi rizgjedhje, nga ortaket.

Shkarkimi i Ekspertit Kontabel te Autorizuar vendose ne te njejtat kushte si emerimi, ne rast se verehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres .

#### **NENI 16**

Fitimi neto i realizuar, pasi jane zbritur rezervat ligjore deri 5% te fitimit te cilat do te krijohen ne shoqeri deri ne shumen 10% te kapitalit dhe tatimet embi fitimin, mbetet ne perdorim te ortakut/eve i/te cilet vendos/in per perdorimin e tij

#### **NENI 17**

Ne rastet kur ortaku/et eshte/jane debitore per kapital te paderdhur sipas perqindjes se pjesemarrjes ne kapital, fitimi neto do te kaloje per shlyerje te detyrimit deri ne masen e plotesimit te % te pjesemarrjes.

### **KREU V**

#### **MARREDHENIET E PUNES**

#### **NENI 18**

Marredheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne kete statut do zbatohen dispozitat e Kodit te Punes te Republikes se Shqiperise. Mosmarreshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert zgjidhja behet ne gjykatën shqiptare. Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit te realizuar nga shoqeria gjate aktivitetit te saj, nese ne kontrate nuk eshte parashikuar ndryshe. Per punen e kryer punonjesit marrin page sic eshte parashikuar ne kontrate.

### **KREU VI**

#### **DISPOZITA TE VECANTA**

#### **NENI 19**

Shoqeria mund te prishet ne cdo kohe dhe per cfaredo lloj shkak, si ne rast falimentimi, privim te drejtave per te ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga ortaku/et.

Shoqeria hyn ne fazen e likuidimit qysh ne momentin e prishjes se saj.

Per kryerjen e ketij procesi, Ortaku/et emerone/jne nje ose disa likuidatore, te cilet i paraqesin atij/atyre raportin mbi gjendjen e Aktivit dhe Pasivit te Shoqerise, mbi

ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe afatin e nevojshem te perfundimit te tyre. Ne fund te procesit te likujdimit, Ortaku/et vendos/in mbi Bilancin perfundimtar financiar mbi aktin e rregullshmerise se punes se likujduesit dhe mbyllje si pjese e likujdimit.

Mbas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesi perkates, likujdatori ndan kapitalet e mbetura per ortakun/et.

## **NENI 20**

Mosmarreveshjet qe mund te lindin ne shoqeri me te tretet, zgjidhen me pajtim, ne te kundert palet i drejtohen Gjykates kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve.

## **DISPOZITA TE FUNDIT**

### **NENI 21**

Shoqeria konsiderohet e krijuar ne perputhje me nenet e ketij statuti dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne Qendren Kombetare te Biznesit, ne baze te Ligjit nr.9723 date 03.05.2007 "Per Rregjistrimin e Biznesit", te ndryshuar .

### **NENI 22**

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut do ti behet referim Ligjit Nr.9901 date, 14/04/2008 "*Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare*", te ndryshuar si dhe legjislacionit koherent.

Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre e procedure me te cilen nxirret vete statuti.

### **NENI 23**

Ky statut u perpilua nga Ortaku themelues duke shprehur vullnetin e tij te plote e te lire.

Ai u perpilua ne 3 (tre) kopje autentike, nje kopje per t'u depozituar ne QKB, nje kopje ortakut dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

**ORTAKU I VETEM**  
**I**  
**SHOQERISE TREGTARE**  
**"ERSEKA SOLAR PARK 3" SH.P.K**





SHOQERIA M&K ENERGY TRADING CO SH.P.K  
ADMINISTRATOR  
VIKTOR QYLAFI

